

VENDIM
Nr. 595, datë 5.9.2012

**PËR KOMPENSIMIN E PUNONJËSIT TË SHËRBIMIT INFORMATIV TË SHTETIT, PËR SHKAK
TË NATYRËS SË VEÇANTË TË PUNËS DHE KUFIZIMEVE LIGJORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 22 të ligjit nr. 9357, datë 17.3.2005 “Për statusin e punonjësit të Shërbimit Informativ të Shtetit”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kur punonjësi i Shërbimit Informativ të Shtetit, për nevoja të punës dhe interesa të shërbimit, caktohet jashtë vendbanimit të tij, përfiton pagesë për kompensim udhëtimi, si më poshtë vijon:

- | | |
|--|-------------------|
| a) Nga 36 km deri 60 km, në masën deri | 8 000 lekë/muaj; |
| b) Nga 61 km deri 100 km, në masën deri | 10 000 lekë/muaj; |
| c) Nga 101 km deri 150 km, në masën deri | 13 000 lekë/muaj; |
| ç) Nga 151 km deri 200 km, në masën deri | 15 000 lekë/muaj; |
| d) Mbi 200 km, në masën deri | 20 000 lekë/muaj. |

Përfitimi i kësaj pagese vazhdon deri në ndryshimin e vendbanimit të punonjësit të SHISH-it, që nënkupton sistemimin me banesë në territorin e juridiksionit të qendrës së punës, ku punonjësi është transferuar. Kjo pagesë do të përfitohet edhe nga punonjësit që janë aktualisht të transferuar, por jo nga punonjësit që emërohen për herë të parë në SHISH.

2. Për përfitimin e pagesës sipas pikës 1 të këtij vendimi, punonjësi i SHISH-it paraqet pranë Drejtorisë Juridike dhe Burimeve Njerëzore, dokumentacionin e poshtëshënuar:

- a) kërkesë me shkrim, me gjenealitetet e plotë, adresën ku banon aktualisht familja e tij, si dhe adresën ku banon përkohësisht vetë punonjësi;
- b) fotokopje të kartës së identitetit dhe certifikatë të gjendjes civile;
- c) vërtetim nga njësia administrative, ku të vërtetohet vendbanimi i familjes dhe i vetë punonjësit të Shërbimit Informativ të Shtetit, pavarësisht nga gjendja civile.

3. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i miratuar për Shërbimin Informativ të Shtetit.

4. Ngarkohet Shërbimi Informativ i Shtetit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha